

## Titulli i lëndës: Analizë e teksteve letrare

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Analizë e teksteve letrare
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	III, semestri -V
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	4
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Naser MRASORI
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:Naser.Mrasori@uni-pr.edu">Naser.Mrasori@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi i lëndës “<b>Analizë e teksteve letrare</b>” ka për qëllim të sjellë, në mënyrë të organizuar, sistematike dhe konceptuale, njohuri praktike për analizën e tekstit letrar, si proces i rëndësishëm për të njohur dhe kuptuar një tekst letrar në ndërtim dhe kuptim. Gjatë kursit do të shqyrtohen çështje të tilla, si: faktorët që ndihmojnë në njohjen e tekstit, ndërtimin, kuptimin, ndarjen, klasifikimin e teksteve letrare, si dhe metodat dhe teknikat e analizës sipas gjinive letrare. Kjo lëndë jepet me ligjërata sistematike dhe me ushtrime përkatëse, të cilat ndërtojnë një bazë të mirëfilltë për studime shkencore në fushën e studimit të tekstit letrar.</p>

Qëllimet e lëndës:

Qëllimi i lëndës është t'i njohë studentët me:

- Tekstin në përgjithësi, tekstin letrar dhe joletrar,
- Metodën dhe teknikat e analizës së teksteve letrare, sipas gjinive letrare (epika, lirika dhe dramatika).
- Analizën e kompozicionit të tekstit letrar
- Strukturën narrative
- Konceptet dhe parimet kryesore të analizës së teksteve letrare.
- Faktoret që ndikojnë në njohjen e kuptimit nëpërmjet analizës së teksteve letrare.
- Klasifikimin e teksteve letrare.

Me njohjen e terminologjisë dhe zhvillimin e shprehjeve të analizës letrare, ndërtimin, kuptimin dhe njohjen e teksteve letrare, nëpërmjet metodave përkatëse të analizës letrare.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Në fund të programit studentët do të marrin njohuri të mjaftueshme:

- për analizën, kuptimin dhe interpretimin e teksteve dhe llojet e teksteve letrare;
- tekstin letrar dhe funksionin e tij;
- për mundësitë që mund dhe që duhet të ofroj analiza letrare
- për shkollat dhe metodat e ndryshme të analizës letrare, që ndihmojnë në kuptimin, interpretimin dhe komentimin e tekstit letrar;
- për formën dhe llojet e analizës letrare;
- për mënyrën e analizimit të një teksti, sipas gjinive letrare;
- si analizohen tekstet epike;
- si analizohen tekstet lirike;
- dhe tekstet dramatike

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

**Aktiviteti**

**Orë**

**Ditë/javë**

Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10min	15	2.5
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	10	1	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz, provim final)	2	1	2
<b>Totali</b>			<b>93.5:25= 3.74 4 ECTS</b>

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi zhvillohet me ligjërata dhe ushtrime-shpjegime përkatëse për analizën dhe interpretimin e tekstit letrar. Gjatë zhvillimit të këtij kursi zbatohen metodat e leximit, analizimit, kuptimit, komentimit dhe interpretimit të teksteve letrare. Gjatë analizimit, interpretimit, komentimit të teksteve letrare do të përzgjidhen tekste nga tri gjinitë letrare, epike, lirike dhe dramatike. Realizimi i këtij kursi bëhet duke shfrytëzuar literaturë të pasur burimore, e cila pëmbush nevojat e duhura për njohuri teorike dhe praktike. Gjatë ushtrimeve dhe shpjegimeve zbatohet metoda ndërvepruese.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi është paraparë të bëhet sipas statutit dhe rregulloreve të Universitetit të Prishtinës, provimi organizohet me shkrim dhe me gojë. Duke pasur parasysh edhe punën dhe angazhimin e studentëve gjatë vitit akademik si p.sh. pjesëmarrja në ligjerata, angazhimi, punimet seminarike, testet, referimet, diskutimet, etj. Rezultati përfundimtar llogaritet si në vijim: - Pjesëmarrja aktive, përfundimi i seminareve dhe detyrave në kohë dhe angazhimi në - Pjesëmarrje, angazhim dhe detyra ( 20%) - Testi i parë (30 %) - Provimi përfundimtar (me shkrim/me gojë) (50%)
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. H. Werner Ludwig. Arbeitsbuch Romananalyse. 5 Auflage.Tübingen, 1995.</li> <li>2. C.Kahrman, G. Reiss, M. Schluchter. Erzähltextanalyse. Eine Einführung mit studien – und Übungstexten.4.Auflage, Beltz, F.am Main, 1996.</li> <li>3. H. Werner Ludwig. Arbeitsbuch Lyrikanalyse. Tübingen, 1994.</li> <li>4. D. Burdorf. Einführung in die Gedichtanalyse. 2.Auflage. J.B.Metzler, Stuttgart,Weimar, 1997.</li> <li>5. Dramenanalyse. 5.Auflage. J.B. Metzler, Tübingen, 1997.</li> <li>6. Peter Wnzel:Einführung in die Erzähltextanalyse.Kategorien,Modelle, Probleme. Verlag</li> </ol>

	<p>Trier,2004.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>7. Jürgen Schutte: Einführung in die Literaturinterpretation: J.B.Metzler Verlag, Stuttgart 1997.</li> <li>8. Eicher/Wiemann Hrsg: Arbeitsbuch: Literaturwissenschaft.UTB für Wissenschaft. Paderborn,Wien,Zürich 1997.</li> <li>9. Harro Müller-Michaels Deutsche Dramen,Interpretation. Beltz Athenaeum. Weinheim 1996.</li> <li>10. Oldenburg Interpretationen: Lyrik des 20.J.h. &amp; Lyrik von 1945 bis zur Gegenwart. Interpretiert von Hermann Korte. Oldenburg, München 2000.</li> </ol>
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Seiffert, Helmut : Einführung in die Hermeneutik</li> <li>2. Teori Letrare. Një hyrje e shkurtë. Era, Prishtinë, 2001.</li> <li>3. Hainz Ludwig Arnold und Heinrich Detering. Grundzüge der Literaturwissenschaft, dtv,1996 (Kap.II: Grundfragen der Textanalyse-Hermeneutische</li> <li>4. Iser,Wolfgang: Der Akt des Lesens, W.Fink,1994</li> <li>1. 5. Iser,Wolfgang: Der implizite Leser, W.Fink,1994.</li> </ol>

<b>Hartimi i planit mësimor</b>	
<b>Java</b>	<b>Titulli i ligjëratës</b>
<b>Java e parë:</b>	Teksti dhe teoria e tekstit; llojet e teksteve; autori dhe teksti; teksti letrar dhe joletrar.
<b>Java e dytë:</b>	Struktura e tekstit. Analiza në tekste letrare dhe joletrare.
<b>Java e tretë:</b>	Rregullat, metodat dhe format e analizës në tekste sipas gjinive letrare.
<b>Java e katërt:</b>	Struktura narrative dhe struktura e ndërtimit në tekstet epike (teksti, interteksti, konteksti).
<b>Java e pestë:</b>	Analiza letrare; analiza kompozicionale e tekstit epik (shembuj nga: romani/ novela/ tregimi)
<b>Java e gjashtë:</b>	Analiza letrare e teksteve lirike
<b>Java e shtatë:</b>	Vargu, strofa dhe llojet e tyre; metrika
<b>Java e tetë:</b>	Metrika, roli dhe rëndësia e saj në analizë
<b>Java e nëntë:</b>	Figurat dhe figuracioni në tekstet lirike

<b>Java e dhjetë:</b>	Analiza dhe intepretimi letrar i teksteve lirike (shembuj; vjersha, elegji, sonet etj.)
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Drama - nocioni, format dhe llojet e dramës Teatri sipas pikëpamjeve Aristoteliane dhe teatri epik i Brehtit
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Analiza letrare e teksteve dramatike
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Analiza sipas gjinive dramatike - Tragjedia, komedia dhe tragjikomedia
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Analizë e komunikimit, ngjarjes dhe ndertimit në tekstet dramatike
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Figurat, karakteret, tipat Analiza kompozicionale e tekstit dramatik

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Mësimi zhvillohet me ligjërata, ushtrime dhe me shpjegime përkatëse për analizën e teksteve letrare. Në fillim do të jepen informacione të përgjithshme në mënyrë që ata të thellojnë dijet e tyre teorike dhe praktike. Në vazhdimësi analizohen shembuj nga gjinitë e ndryshme letrare, me qëllim që ata të arrijnë pavarësinë të bëjnë analizë të thellë teksteve . Gjatë realizimit të këtij kursi, shfrytëzohet literaturë e pasur burimore dhe zbatohet metoda ndërvepruese

Përmes këtij kursi studentët pritet të thellojnë dijet përmes metodave dhe politikave të reja akademike, studentët duhet të vijnë me kohë në sallën e mësimit, atyre u kërkohet të jenë aktiv në pjesëmarrje, gjatë ligjëratave, në referime, diskutime, si dhe në punë seminarike.